

PROJEKTI “SHKOLLAT PËR SHËNDE TIN”



Ja çfarë ka ndodhur në vitin e tretë të projektit!

Mirësevini në buletinin tonë të katërt! Kemi kënaqësinë të ndajmë me ju arritjet më të fundit të vitit të tretë të zbatimit të projektit “Shkollat për Shëndetin”.

Në vitin e tretë të zbatimit (Mars 2023-Shkurt 2024), projekti ka pasur ndërhyrje të thelluara në tre rajone të reja në Shqipëri përkatësisht në Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Projekti “Shkollat për Shëndetin” është një projekt kombëtar i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nga Save the Children Albania.

Ky Projekt synon promovimin e sjelljeve të shëndetshme mes fëmijëve të shkollave

9-vjeçare (të moshës 6-16 vjeç) në Shqipëri me qëllim që ato, familjet e tyre përkatëse dhe komunitetet në tërësi angazhohen në praktika dhe sjellje të shëndetshme shëndetin nëpërmjet një sërë ndërhyrjesh të thelluara.

Projekti “Shkolla për Shëndetin” shpreh mirënjohje të thellë për donatorin dhe partnerët tanë që vazhdojnë të mbështesin projektin që prej fillimit të tij. Falë angazhimit dhe përkushtimit të tyre, është bërë e mundur që projekti të zbatohet me efektivitet dhe të ketë impaktin e duhur në popullatë, sidomos tek fëmijët.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme!

KY BULETIN DO T’JU OFROJË:

Përmbledhje të arritjeve kryesore të projektit “Shkollat për Shëndetin” në vitin e tretë të implementimit të tij.



KOMPETICIONE SPORTIVE NË VRAKË, SHKODËR



KONVENTA RAJONALE PËR KOORDINATORËT E SHËNDETTIT NË SHKOLLË, DURRËS

Arritjet e “SHKOLLAT PËR SHËNDETTIN” në vitin e tretë...

Gjatë vitit të tretë të implementimit të tij, projekti “Shkollat për Shëndetin” ka arritur pjesëmarrje aktive me 28.411 persona, ku 23.941 prej tyre ishin fëmijë.

48.5% e fëmijëve që kanë përfituar nga ndërhyrjet e projektit janë në zona rurale. Projekti synon një përfshirje të gjerë dhe të balancuar të fëmijëve në ndërhyrjet e thelluara, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në promovimin e shëndetit.

Për më tepër informacion ju lutemi vizitoni:

<https://shkollatpershendetin.al/al/>

Gjithashtu, përmes ndërhyrjeve online të projektit janë arritur 50.627 individë, duke ndihmuar në përmirësimin e njohurive në lidhje me zakonet e mira dhe stilin e jetesës së shëndetshme.

Gjithashtu, 115.979 individë janë arritur përmes mjeteve të komunikimit masiv duke përfshirë kanalet televizive dhe mediat digjitale, nëpërmjet platformave të ndryshme të mediave sociale.



Shkolla “Qamil Guranjaku”, Elbasan

Ofrimi i granteve për pushtetin vendor, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe agjentët kryesorë të ndryshimit


Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka zgjeruar partneritetet e tij të qëndrueshme duke forcuar kapacitetet e përfaqësuesve të pushtetit vendor, Organizatave të Shoqërisë Civile (SCO) dhe agjentëve kryesorë të ndryshimit që përfshijnë sektorin privat.

Nëpërmjet bashkëpunimit shumësektori-

al dhe ndërsektorial, projekti ka realizuar me sukses ndërhyrje të ndryshme, të cilat rezultojnë në ndërtimin e kopshteve dhe këndeve të lojrave në shkollat 9-vjeçare dhe në ambiente të gjelbërta për fëmijët në Helshan-Has, rajoni i Kukësit, Korçë dhe Maliq.

Zgjerimi i qasjes në KUJDESIN DENTAR për fëmijët në zonat rurale të Shqipërisë nëpërmjet njësive dentare

Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në blerjen e dy kabineteve dentare në shkollën “Pashko Vasa”, Mirditë dhe “Gjon Gjona”, Laç, si dhe disa autoklavave (pajisje sterilizimi) të nevojshme për funksionimin e kabineteve të kujdesit dentar në shkollë.



Njësia dentare në shkollën “Gjon Gjona”, Laç



Gjithashtu, gjatë vitit të tretë të implementimit, ka nisur fushata ndërgjegjësuese për Shëndetin Oral, që synon fëmijët dhe familjet e tyre.

Nxënësit e shkollave avokojnë rregullisht për promovimin e të drejtave të tyre në shëndetësi dhe përdorin rrjetet sociale të shkollave të tyre si kanale për aktivitetet e tyre avokuese.

Në krye të këtyre aktiviteteve janë ato që përfshijnë promovimin e shëndetit oral. Për përkujden dhe avokimin e rëndësisë së shëndetit oral, ka vijuar puna me vizitat në terren të njësive lëvizëse dentare të gjeneratës së fundit (sipas standartit të FDI) që janë mbështetur nga projekti. Përmes shërbimeve të ndryshme që ofrohen nga këto njësi lëvizëse, kanë përfituar shkollat që kryesisht janë në zonat rurale dhe të thella, ku prioritet janë fëmijët e moshave 6-14 vjeç dhe personat në nevojë. Në total, prej fillimit të programit, nga njësitë lëvizëse dentare kanë përfituar 5827 fëmijë.

ZGJERIMI I RRJETIT të Koordinatorëve të Shëndetit në Shkolla

Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka zgjeruar rrjetin e Koordinatorëve të Shëndetit në Shkolla duke përfshirë 30 shkolla të tjera. Rrjeti i Koordinatorëve të Shëndetit në Shkolla funksionon në 90 shkolla në të gjithë vendin.

Rrjeti luan një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e përvojave dhe përhapjen e shkallëzuar të praktikave më të mira nëpërmjet takimeve të rregullta. Ai promovon rolin e Koordinatorëve të Shëndetit në Shkolla (SHC) në kryerjen e aktiviteteve të shumta të edukimit shëndetësor që promovojnë stilin e jetës dhe sjelljeve të shëndetshme.

EDUKIMI I FAMILJEVE të shëndetshme përmes fushatave të prindërimit pozitiv dhe FUQIZIMI i prindërve për një mënyrë jetese të shëndetshme

Në vitin e tretë të projektit, fushatat e prindërimit pozitiv kanë synuar përfshirjen e prindërve dhe anëtarët e komunitetit në zonat urbane dhe rurale në rajonet e Shkodrës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Më shumë se 1,961 prindër, 84% e tyre gra, kanë marrë pjesë në një seri sesionesh të prindërimit pozitiv dhe ndërhyrjesh, që promovojnë një stil jete dhe zakone të shëndetshme: si ushqimi i shëndetshëm, praktikatat e duhura higjienike dhe praktikatat e sigurta mjedisore, etj.

RRITJA E KAPACITETEVE TË STAFEVE të shkollave dhe specialistëve të promovimit të shëndetit në nivel vendor



Trajnimi i trajnerëve (ToT), shkolla “Ismail Qemali”, Shkodër

Pjesëmarrës të trajnuar



Gjatë vitit të tretë të implementimit të projektit “Shkollat për Shëndetin”, projekti ka ndërhyrë në rritjen e kapaciteteve të mësuesve, specialistëve të promovimit të shëndetit, përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile, duke filluar fil-

limisht me trajnimin e trajnerëve, të ndjekur nga trajnime në modelin kaskadë, veçanërisht me sesione trajnimi onsite brenda tre rajoneve të targetuara për ndërhyrje të thelluar (Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë), si dhe trajnime online në qarqet e tjera në të gjithë Shqipërinë.

Fushata për promovimin e shëndetit dhe ndikimi i fëmijëve nga fushatat “KARAVANI I SHËNDETIT”

Fushatat e promovimit të shëndetit janë zhvilluar me synimin për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e zakoneve të shëndetshme tek fëmijët, prindërit dhe mësuesit nëpërmjet fushatave të Karavanit të Shëndetit në të cilat janë mbajtur në Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë. Nëpërmjet projektit “Shkol-

lat për Shëndetin” kanë përfituar rreth 60.1% të nxënësve në qarkun e Shkodrës, 34.1% e nxënësve në qarkun e Vlorës dhe rreth 81.7% e nxënësve në qarkun e Gjirokastrës. Në total rreth 18,114 fëmijë kanë përfituar nga aktivitetet e realizuara në terren në kuadër të projekti “Shkollat për Shëndetin”.



Kompeticion sportiv në shkollën “Gjergj Vatë Martini” në Velipojë, Shkodër



Karavani i Shëndetit në Vlorë

Nxënësit kanë patur një pjesëmarrje aktive në aktivitetet e fushatave të karvanit të shëndetit, duke përfshirë organizimin e panireve të ushqimit, duke avokuar për rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme, përfshirjen në aktivitete fizike dhe sportive, trajnimin e shëndetit mendor dhe bullizmin, si dhe pjesëmarrjen në nisma që promovojnë një mjedis të pastër dhe të sigurt.



Fushata e Karavanit të Shëndetit, në Gjirokastrë, Tetor 2023

KONTRIBUTI i dhënë për përfshirjen sociale të komuniteteve në nevojë, zonave rurale, fëmijëve/prindërve/kujdestarëve me aftësi të kufizuara si dhe familjeve që i përkasin skemës së ndihmës ekonomike

Të gjitha shkollat e përzgjedhura për ndërhyrje të thelluara në vitin e tretë konsistojnë në shkolla në zonat urbane, peri-urbane dhe rurale dhe përfshinin gjithashtu komunitete vulnerabël (minoritetet rome/egjiptiane, apo zona të varfra të vendit) si në vijim:

- Fëmijë romë/egjiptianë: 493 (253 vajza dhe 240 djem);
- Fëmijë nga familje të varfra: 1.267 (633 vajza dhe 634 djem);
- Fëmijë me nevoja të veçanta: 129 (54 vajza dhe 75 djem);
- Prindër/kujdestarë romë/egjiptianë: 63 (61 femra dhe 2 meshkuj);
- Prindër/kujdestarë në varfëri: 153 (150 femra dhe 3 meshkuj).



Konkurse Dixhitale

Aplikacionet digjitale dhe Konkursset Digjitale të Shëndetit

Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe të kuptuarit të stilit dhe zakoneve të shëndetshme të jetës tek fëmijët në Shqipëri përmes përdorimit të aplikacioneve digjitale dhe pjesëmarrjes në konkurset digjitale kombëtare. Në vitin e tretë të tij janë zbatimit u zhvilluan 6 konkurse digjitale kombëtare me pjesëmarrjen e 2313 fëmijëve. Nëpërmjet këtyre konkurseve, përveç fëmijëve kishte përfshirje të mësuesëve dhe prindërve në nxitjen, udhëzimin dhe orientimin e fëmijëve të shkollave që të merrnin pjesë në këto konkurse të cilat u shoqëruan më një fazë paraprake të shpërndarjes së informacionit rreth tematikës së konkursit që nxënësit të kishin mundësi të njoheshin me informacionin. Fitues u shpallën jo vetëm fëmijët, por edhe shkollat me më shumë pjesëmarrje.

FORCIMI I KAPACITETEVE të shkollës për promovimin e shëndetit të fëmijëve

Nga synimet kryesore të projektit “Shkollat për Shëndetin” është edhe forcimi i kapaciteteve të shkollave për ofrimin e një mjedisi të shëndetshëm për fëmijët. Përmes ndërhyrjeve të thelluara të Projektit të zbatuara në Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër, u mundësua krijimi i 16 klasave - klube shëndeti dhe qendra burimore - të cilat krijojnë mundësinë në zgjerimin e hapësirave për kryerjen e aktiviteteve extra kurrikulare të lidhura me shëndetin në shkollë.

Krijimi i 7 Klubeve të Shëndetit (4 prej

tyre të cilave në zonat rurale), kanë ofruar mundësinë e për të mësuar dhe diskutuar tema të lidhura me shëndetin dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në këtë kuadër.

Gjithashtu, 9 qendra burimore (nga të cilat 3 janë në zonat rurale), janë krijuar ose rinovuar brenda shkollave për të shërbyer si burime të vlefshme informacioni si për nxënësit ashtu edhe për prindërit, me fokus të veçantë në plotësimin e nevojave të fëmijëve me kërkesa të veçanta.



Qendra burimore, shkolla “Ndre Mjeda”, Shkodër

Faleminderit për vëmendjen tuaj!